



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

Nr. 977/prot.
15

Tiranë më 13. 7. 2018

VENDIM

Nr. 33, datë 13. 7. 2018

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja, Znj. _____ ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 977 Prot., datë 04.06.2018, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Bashkisë Cërrrik” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Ankuesja në cilësinë e kërkueses, nëpërmjet kërkesës datë 04.05.2018 ka kërkuar nga Autoriteti Publik t’i vihete në dispozicion dokumentacioni si më poshtë:

- *Raportin e plotë përfundimtar të auditit të K.L.SH të ushtruar në Bashkinë Cërrrik për periudhën Janar – Mars 2017.*

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesja ka paraqitur ankimin nr. 977 Prot., datë 04.06.2018 pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, me shkresën nr. 977/1 Prot., datë 11.06.2018 ka kërkuar nga Autoriteti Publik rivlerësimin e dhënies së informacionit brenda datës 19.06.2018.

Me shkresën nr. 977/2 Prot., datë 22.06.2018, Autoriteti Publik ka rivlerësuar kërkesën, duke sqaruar se: *“Dokumentacioni i kërkuar gjëndet i aksesueshëm në faqen zyrtare të KLSH - së dhe pikërisht vendimi nr.36, datë 28.04.2017 “Për auditimin e ushtruar në bashkinë Cërrik”. Megjithatë Bashkia Cërrik në datë 25.05.2018 i ka kthyer përgjigje kërkesit duke i bashkangjitur dhe dokumentacionin e kërkuar”.*

Edhe pas rivlerësimit të kërkesës, konstatohet se Autoriteti Publik nuk i ka vënë në dispozicion kërkuases informacionin sipas objektit të kërkesës.

Me anë të e-mailit datë 28.06.2018, Zyra e Komisionerit ka kontaktuar me Koordinatorin për të Drejtën e Informimit pranë Autoritetit Publik, duke kërkuar përmbushjen e detyrimit për vënien në dispozicion të *“Raportit të plotë përfundimtar të auditit të K.L.SH të ushtruar në Bashkinë Cërrik në Janar – Mars 2017”*, brenda datës 29.06.2018.

Autoriteti Publik, me anë të e-mailit datë 29.06.2018, ka refuzuar vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, duke argumentuar ndër të tjera se: *“Në lidhje me raportin përfundimtar është bërë mbledhje administrate dhe janë pasqyruar të gjitha vendimet e tij, ku prezente ka qënë edhe kërkuësja. Në këtë mbledhje është qartësuar edhe pozicioni i saj dhe i gjithë personave të përmendur në këtë raport. Bashkia Cërrik është në fazën e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, prandaj beson se deri në përfundim të këtij procesi, ky raport nuk duhet të shpërndahej tek persona të tretë të cilët, mund të prishin procesin. Në raportin e plotë janë të përmendur emra konkretë punonjësish, të cilët dyshojmë se mund të keqpërdoren prej ankueses dhe të ndikojnë në performancën e tyre në punë, por edhe në jetën private”.*

Komisioneri vlerëson se, arsyetimi i bërë nga Autoriteti Publik për refuzimin e kërkesës së sipërcituar është i gabuar. Detyrimi për dhënie informacioni nuk konsiderohet i përmbushur, nëse ankueses nuk i vihet në dispozicion një kopje e dokumentit të kërkuar, pavarësisht se kjo e fundit është konsultuar me të.

Theksojmë se dokumenti objekt i kërkesës është akt përfundimtar i nxjerrë nga institucioni i KLSH-së në kuadër të ushtrimit të detyrave të saj funksionale dhe për këtë arsye nuk mund të çënojë procesin e zbatimit të rekomandimeve të lëna prej saj.

Bazuar në pikën dh) të nenit 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, çdo Autoritet Publik vë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet *“mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit”.* Pra, informacioni i kërkuar bën pjesë në atë kategori informacioni i cili duhet t’i vihet në dispozicion publikut pa kërkesë.

Nga ana e Autoritetit Publik, gjatë publikimit të raporteve përfundimtare të KLSH-së, duhet treguar kujdes në publikimin e të dhënave të personave të tretë të cilët përmenden në mënyrë sporadike në këto raporte, por që nuk kanë rol përfaqësues tek operatorët ekonomike të përfshirë në procedurat e prokurimit publik objekt raportimi. Në këto raste identiteti i tyre, por edhe të dhëna të tjera të cilat mund të identifikojnë ato në mënyrë indirekte duhet të bëhet në formë të anonimizuar.

Theksojmë gjithashtu se, Ligji për të Drejtën e Informimit ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike. Njësitë e qeverisjes vendore kanë këtë detyrim edhe në zbatim të Kreut VI, të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", konkretisht, Neni 15 "Transparenca e veprimtarisë së njësive të vetëqeverisjes vendore", në të cilin parashikon se: "1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre".

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, "Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit original ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit".

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Znj. _____ ndaj Bashkisë Cërrik, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mos marrëveshjeve administrative", i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin ankesës Nr. 977 Prot., datë 04.06.2018 të Znj. _____, ndaj Autoritetit Publik "Bashkia Cërrik", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar sipas objektit të kërkesës, raportin e plotë përfundimtar të auditit të K.L.SH të ushtruar në Bashkinë Cërrik për periudhën Janar – Mars 2017, brenda datës 20.7.2018
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
4. Ky vendim u dha shpall sot në datë 13.7.2018.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

